

Veproni me maturi: tregohuni më i zgjuar sesa reklamat dhe kurthet e internetit!

Kliko personazhet e mëposhtëm për të zbuluar sekretet!



Zbulo kostot e fshehura të platformave "falas"



Bëj kujdes nga kurthet e marketingut



Njih të drejtat e tua në internet

Kostot e fshehura të platformave “falas”

Shumë uebsajte, rrjete sociale dhe aplikacione, si “YouTube”-i, “Instagram”-i, “TikTok”-u ose “Roblox”-i, të japin përshtypjen sikur janë falas. Por, në të vërtetë, nuk janë aspak të tilla.



Kompanitë përdorin taktika të zgjuara për të fituar para.



Kostot e fshehura të platformave “falas”

● Reklamata në internet

Njëra prej mënyrave për të fituar para është **reklamimi** – një kompani paguan për të shfaqur reklama ose sponsorizon ndonjë filtër në aplikacione mesazhesh, siç është “Snapchat”-i.



● Të dhënat personale


Po ashtu, ato mund t’i përdorin ose t’i shesin të dhënat e tua personale, ose të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me ty. Këtë e bëjnë, për shembull, për të shfaqur reklama ose postime që do të të pëlqejnë.

Kompanitë besojnë se, nëse ti pëlqen ndonjë reklamë, atëherë ke shumë të ngjarë ta blesh produktin që reklamohet në të.



Kostot e fshehura të platformave “falas”

Tani, kur ti i hap këto uebsajte ose aplikacione, këta veprojnë si detektivë digjitalë.



Ato mbledhin të dhëna rreth teje—**emrin, moshën, pasionet (hobët), postimet që të kanë pëlqyer, llogaritë që ndjek, vendndodhjen, fotografitë që ke postuar** madje edhe të dhëna për pajisjen tënde (**telefonin, tabletin etj.**).

Me një fjalë, këto platforma janë duke e ndërtuar profilin tënd, pjesë-pjesë.

Kostot e fshehura të platformave “falas”

Profili i personalizuar



Companies often advertise to young consumers, such as you. Why? Well, you have some superpowers:

para xhepi për të shpenzuar në internet


aftësinë për t'i bindur prindërit që të të blejnë këtë ose atë gjë




Bëj kujdes nga kurthet e marketingut



● Rëndësia e parave: influencersit



Influencuesit që ti ndjek në internet, në platforma si “YouTube”-i ose “TikTok”-u, ndonjëherë **paguhen** për të folur për produkte të ndryshme (rroba, produkte të kujdesit të lëkurës, lodra, ushqime etj.), për organizime shoqërore ose për vende turistike.



Ka shumë influencers që nuk të thonë se po bëjnë reklamë (edhe pse duhet të ta thonë!). Ata sillen sikur po shprehin mendimet e tyre të vërteta!

Bëj kujdes nga kurthet e marketingut




● Rëndësia e parave: videolojërat

Në botën digjitale, lojërat zbavitëse dhe takimet virtuale (si në "Metaverse") mund të kenë disa reklama të fshehura.

Do të vëresh edhe disa që janë shumë të dukshme, për shembull

reklammat që shfaqen
befas në ekran



Të tjerat nuk bien aq në sy, siç janë

reklammat në tabela ose
surprizat në sfond



Këshilla e parë



Pyet veten

- Mos po më shesin diçka me këtë postim?
- A më duket i besueshëm ky informacion?
- Sa është çmimi i “vërtetë” i kësaj?



Këshilla e dytë



Ndrysho cilësimet

- Ndrysho cilësimet e privatësisë në telefon, aplikacione ose videolojëra.
- Disa vende të lënë të zgjedhësh që të mos të të shfaqen reklama, për shembull, nëse abonoresh ose paguan një herë.
- Mund të çaktivizosh aktualitetin (feed-in) e personalizuar, për të ndryshuar llojin e postimeve që të shfaqen.



Këshilla e tretë

Kupto mënyrën se si i shpenzon ti paratë

- Diskuto me prindërit ose me një person të rritur të besueshëm në lidhje me shpenzimet në internet.
- Kushtoji vëmendje asaj nëse çmimet jepen në valutë virtuale apo reale.
- Përpara se të blesh diçka, kupto dallimin midis këtyre dhe “koston e vërtetë”.



Këshilla e katërt



Kontrollo të dhënat e tua

- Kushtoj vëmendje “Kushteve të përdorimit” të platformave që je duke përdorur.
- Kërko informacione nga kompanitë që mbledhin të dhënat e tua.
- Kërkoju t’i korrigojnë ose t’i fshijnë të dhënat e tua, ose të mos i përdorin më për marketing.



Si i ri ose e re që je, ti ke të drejtë:

1

Të kalosh mirë në internet, të shpërndash informacione, të shohësh video të këndshme dhe të luash videolojëra pa reklama bezdisëse.

2

Të ruash privatësinë e të dhënave të tua personale në rrjetet sociale, aplikacione dhe videolojëra.

3

Të mbrohesh nga shfrytëzimi tregtar në rrjetet sociale, aplikacione dhe videolojëra.

4

Të të dëgjohet mendimi gjatë hartimit të rregulloreve të reja për botën e internetit dhe gjatë projektimit të veglave ose instrumenteve të reja.

5

Të ankohesh në rast se të shkelen të drejtat.

Njih të drejtat e tua në internet



Kjo nënkupton që kompanitë nuk mund të përpiqen të të manipulojnë ose të ushtrojnë ndikim te ti në mënyra që ta bëjnë të vështirë të vendosësh vetë, për shembull, për të blerë ndonjë send ose artikull që përdoret në videolojë.



Influencuesit dhe kompanitë duhet të ndjekin rregullat

Njih të drejtat e tua në internet

Influencuesit duhet:



Të tregohen të sinqertë që po bëjnë reklamë

Në reklamata që bëhen në video ose në fotografi duhet të thuhet se ato janë të tilla, d.m.th. reklama. Influencuesit mund të përdorin hashtagët "#advertising" ose "#ad" (#reklamim ose #reklamë), të etiketojnë markat tregtare ose të japin një njoftim në aplikacion.



Kompanitë duhet:



Të ruajnë privatësinë e të dhënave të tua personale

Sipas rregullave të reja të BE-së, platformave në internet u ndalohet të të shfaqin reklama duke u mbështetur në gjërat që ato dinë për ty.



Të mbrojnë të dhënat e tua

Kompanitë duhet të kufizojnë sasinë e të dhënave personale që mbledhin, sidomos nëse këto i përdorin për qëllime marketingu.

Kompanitë nuk duhet:



Të luajnë me emocionet e tua

Kompanitë nuk duhet të përdorin marifete që të bëjnë të ndihesh keq ose fajtor, me qëllim që të të shtyjnë të blesh gjëra.



Të të bëjnë presion

Reklamata nuk duhet të të detyrojnë të blesh gjëra dhe as të të inkurajojnë t'u kërkoh gjëra prindërve. Nuk lejohet përdorimi i taktikave të tilla si numërimi mbrapsht ose shfaqja e ofertave urgjente në videolojëra.




Raporto lëndën e pasigurt

- Raporto çdo lëndë (përmbajtje) që ka të bëjë me ty ose që ti mendon se mund të jetë e dëmshme.
- Diskutoji këto situata me dikë të cilit i beson.



Nëse beson se po të shkelin të drejtat e tua, kontakto me Qendrën kombëtare për Internet më të Sigurt për të marrë ndihmë në lidhje me raportimin ose me kontaktimin me autoritetet e duhura.



[Për të mësuar më shumë, hidhu një sy burimeve të platformës "AdWiseOnline"!](#)



Better Internet for Kids

